

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEÇ / OPŠTINA GRAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEÇ
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1063 Nr. i faq./Br. str./No. pg 107
Data/Datum/Date 13/08/2020
RAHOVEÇ / GRAHOVAC



KUVENDI KOMUNAL RAHOVEÇ

2020

PROCESVERBAL-RAPORT I DËGJIMEVE BUXHETORE ME QYTETARË PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT PËR VITIN 2021



HYRJJE

Buxheti është akti më i rëndësishëm komunal që shqyrtohet dhe miratohet në Kuvend Komunal në baza vjetore bazuar në parashikime afatmesme tri vjeçare. Institucionet komunale kanë kompetenca që ndikojnë drejtpërsëdrejti në kualitetin e jetës së qytetarëve duke filluar nga ndërtimi i rrugëve, trotuarëve, shkollave dhe qendrave të mjekësisë familjare e deri tek subvencionimi i veprimtarive ekonomike, agrokulturore e kulturore.

Buxheti që hartohet çdo vit nga të hyrat e parasë publike, përcakton se çfarë projekte dhe shërbime do t'u ofrohen qytetarëve, andaj duhet të jetë i shpërndarë mirë dhe i konsultuar me qytetarët. Me konsolidimin e qeverisjes lokale, buxhetet komunale janë rritur dukshëm dhe janë bërë të rëndësishëm për zhvillimin e lagjeve dhe fshatrave.

BUXHETI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

Buxheti i Komunës së Rahovecit, ndahet në:

- ▶ **Grandi i përgjithshëm**
- ▶ **Grandi specifik për Arsim**
- ▶ **Grandi specifik për Shëndetësi**
- ▶ **Financimi i Këshillit të Hoçës së Madhe**
- ▶ **Të hyrat vetanake**

Grandi i qeveritar	13,391,982,€
Të hyrat vetanake	1,156,841,00 €
Gjithsej	14,548,823€

DËGJIMET BUXHETORE ME QYTETARË

Njëra ndër parimet bazë për një qeverisje të mirë është zotimi se do të mbahen konsultime publike në lagje dhe fshatra. Arsyeja pse është përzgjedhur ky zotim është që të fuqizohet qeverisja e mirë, bazë e së cilës është pjesëmarrja qytetare në draftim të politikave lokale përfshirë buxhetin, për një qeverisje gjithëpërfshirëse.

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 61 e obligon Kuvendin Komunal pas pranimi të propozim buxhetit të mbajë dëgjime buxhetore dhe më pas ta shqyrtojë dhe ndryshojë (siç e sheh të arsyeshme) draft buxhetin sipas inputit të qytetarëve, ndërsa Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna ofron detaje se si duhet të informohen qytetarët për takime publike, përfshirë dëgjimet buxhetore, dhe detajon procedurat për mbarrëvajtjen e tyre.

Në bazë të nenit 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 61 paragrafi 2 Të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr.03/L-048, neni 17, 18 pika 1.7 dhe 19 i Statutit të

Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryesuesi i Kuvendit në koordinim me Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, organizojnë dëgjime publike rreth përgatitjes së buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2021.

INFORMIMI RRETH MBAJTJES SË DËGJIMEVE BUXHETORE

Një nga sfidat kryesore të dëgjimeve buxhetore është mënyra e informimit të qytetarëve. UA për transparencë i obligon komunat që paralajmërimin e publikut për mbajtje të takimeve publike ta bëjnë përmes shpalljeve publike, mediave, ueb faqes dhe rrjeteve sociale të komunës 14 ditë para mbajtjes së dëgjimit. Komuna e Rahovecit ka bërë njoftimin për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore 14 ditë para mbajtjes së takimeve pikërisht më datë 22 qershor 2019, përmes shpalljeve publike, mediave, ueb faqes dhe rrjeteve sociale të komunës. Njoftimi ka përfshirë informata si data, koha dhe vendi i takimit, publikuar njoftimi, njoftimin mund ta gjeni në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2020/06/Kalendari-i-degjimeve-publike-me-qytetaret-e-Komunes-se-Rahovecit-per-buxhetin-e-vitit-2021.pdf>.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Rahovecit, z.Afrim Dina ka përgatitur kalendarin e dëgjimeve publike me qytetar për buxhetin e Komunës së Rahovecit për vitin 2021, në kuadër të këtij kalendar janë paraparë që të mbahen 9 (nëntë) dëgjime publike me qytetarë. Dëgjimet publike me qytetarë, janë paraparë të fillojnë nga data 6 korrik dhe kanë përfunduar më datë 16 korrik 2020, janë mbajtur gjithsej 9 (nëntë) dëgjime publike me qytetarë ashtu siç edhe ishte e paraparë me kalendarin e dëgjimeve publike, kalendarin mund ta gjeni në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/nees/ky-eshte-kalendari-i-degjimeve-publike-me-qytetare-te-komunes-se-rahovecit-per-buxhetin-e-vitit-2021/>.

Dëgjimet publike publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021, janë përcjellur edhe nga Zyra e Kuvendit Komunal Rahovec, si dhe Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, nga zyrtari për informim çdo ditë pas mbajtjes së dëgjimit publik në ueb faqen zyrtare të komunës së Rahovecit, janë publikuar të dhënat e mbajtjes së dëgjimeve me fotografi dhe të dhëna tjera të nevojshme.

Në këtë raport- procesverbal do të paraqiten edhe linqet e njoftimeve të publikuara nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, në Komunën e Rahovecit, nga zyrtari për Informim, z.Haziz Krasniqi.

PROCESVERBAL- RAPORT MBI DËGJIMET BUXHETORE

Data: 03/07/2020:	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e dëgjimit publik me banorët e fshatrave Krushë e Madhe, Celinë, Nagavc, Hoçë e Vogël dhe Brestoc	https://kk.rks-gov.net/rahovec/neës/njoftim-per-banoret-e-fshatrave-krushe-e-madhe-celine-nagavc-hoce-e-vogel-dhe-brestoc-per-organizimin-degjimeve-publike-me-banore-per-pergatitjen-e-buxhetin-te-vitit-2021/
Data: 06/07/2020:	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e dëgjimit publik me banorët e fshatrave: Malësi e Vogël, Gexhë, Ratkoc, Dejnë, Vrajakë dhe Bratotin	https://kk.rks-gov.net/rahovec/neës/njoftim-per-banoret-e-fshatrave-malesi-e-vogel-gexhe-ratkoc-dejne-vrajake-dhe-bratotin-per-organizimin-degjimeve-publike-me-banore-per-pergatitjen-e-buxhetin-te-vitit-2021
Data: 07/07/2020:	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e dëgjimit publik me banorët e fshatrave: Çifllak, Polluzhë, Dobidol, Kramovik, Guri i Kuq dhe Mrasor	https://kk.rks-gov.net/rahovec/neës/njoftim-per-banoret-e-fshatrave-cifllak-polluzhe-dobidol-kramovik-guri-i-kuq-dhe-mrasor-per-organizimin-degjimeve-publike-me-banore-per-pergatitjen-e-buxhetin-te-vitit-2021/
Data: 09/07/2020	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e dëgjimit publik me banorët e fshatrave: Fortesë, Sapniq, Pataqan i Ulët, Pataqan i Epërm dhe Xërxe	https://kk.rks-gov.net/rahovec/neës/njoftim-per-banoret-e-fshatrave-fortese-sapniq-pataqan-i-ulet-pataqan-i-eperm-dhe-xerxe-per-organizimin-degjimeve-publike-me-banore-per-pergatitjen-e-buxhetin-te-vitit-2021/
Data: 10/07/2020	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e dëgjimit publik me banorët e fshatrave: Drenoc, Pastasellë, Senoc, Zatriq, Kaznik dhe Nushpal	https://kk.rks-gov.net/rahovec/neës/njoftim-per-banoret-e-fshatrave-drenoc-pastaselle-senoc-zatriq-kaznik-dhe-nushpal-per-organizimin-degjimeve-publike-me-banore-per-pergatitjen-e-buxhetin-te-vitit-2021/
Data: 13/07/2020	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e dëgjimit publik me banorët e fshatrave: Opterushë, Zaqisht, Retijë dhe Retijë e Epërme	https://kk.rks-gov.net/rahovec/neës/njoftim-per-banoret-e-fshatrave-optreushe-zoqisht-retije-dhe-retije-epërme-per-organizimin-e-degjimeve-publike-per-pergatitjen-e-buxhetin-te-vitit-2021/
Data: 14/07/2020	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e dëgjimit publik me grupin e Grave-Buxhetimi gjinor, OJQ-të,	https://kk.rks-gov.net/rahovec/neës/njoftim-per-grupin-e-grave-buxhetimi-gjinor-ojq-te-dhe-bizneset-per-organizimin-e-degjimeve-publike-per-pergatitjen-e-buxhetin-te-vitit-2021/
Data: 14/07/2020	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e dëgjimit publik me banorët e fshatit Hoçë e Madhe dhe të rinjtë e komunës së Rahovecit	https://kk.rks-gov.net/rahovec/neës/njoftim-per-banoret-e-fshatit-hoce-e-madhe-dhe-te-rinjte-per-organizimin-e-degjimit-publike-per-pergatitjen-e-buxhetin-te-vitit-2021/
Data: 15/07/2020	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e dëgjimit publik me banorët e lagjeve në qytetin e Rahovecit	

Në raport – procesverbal ju do të gjeni të përmbledhura edhe:

- **Procesverbalin e dëgjimeve publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021**
- **Fotografi nga dëgjimet publike me qytetarët e Komunës së Rahovecit për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021.**
- **Kalendarin e dëgjimeve publike me qytetarët e Komunës së Rahovecit për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021.**

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA, KUVENDI KOMUNAL, DREJTORËT E DREJTORIVE

Gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021 Komiteti për Politikë dhe Financa i kryesuar nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal z.Afrim Dina, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani kanë përcjellur vazhdimisht ecurinë e dëgjimeve publike me qytetarë të Komunës së Rahovecit për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021, Komiteti për Politikë dhe Financa konsiderohet si organi kryesor i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht pothuajse të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës.

Komiteti për Politikë dhe Financa, posaçërisht, dhe Kuvendi i Komunës në përgjithësi, kanë përgjegjësi të madhe në fazat e planifikimit dhe mbikëqyrjes së financave komunale. Në fazën e planifikimit, Komiteti për Politikë dhe Financa shqyrton dokumente të rëndësishme si buxheti komunal, korniza afatmesme buxhetore komunale, plani i prokurimit dhe i jep rekomandimet për veprime Kuvendit të Komunës.

Kuvendi i Komunës duke marrë parasysh edhe rekomandimet nga komiteti për politikë dhe financa, do të shqyrtojë, dhe në rast pajtimi, të miratojë, dokumentet kyçe të komunës që lidhen me menaxhimin e financave komunale.

Dëgjimet publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021, në secilin lokalitet janë udhëhequr nga Kryesuesi i KK-Rahovec z.Afrim Dina, pasuar më pas nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani i cili në secilin dëgjim të mbajtur ofroi informacionet e nevojshme lidhur me ndarjen e kategorive të buxhetit në : Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shërbime Komunale, Subvencione e transfere dhe Investime Kapitale, të pranishmit në secilin dëgjim publik të mbajtur patën mundësi të informoheshin nga drejtori i DBF-së edhe për totalin e buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2021 e që në tërësi është: **14,548,823€**.

Kontribut të madh në dëgjime publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021, patjetër që kanë dhënë edhe anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, z.Rasim Fazliu, z.Dervish Cadraku, z.Fehmi Cena, znj.Fahrije Lushi- Morina, znj. Florida Bajraktari dhe znjsh.Fjolla Duraku të cilët gjatë gjithë kohës kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë e tyre karshi qytetarëve të Komunës së Rahovecit për të dëgjuar dhe marrë kërkesat, prioritetet, nevojat dhe shqetësimet e qytetarëve të secilit lokalitet të Komunës së Rahovecit.

Pjesëmarrës në dëgjime publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021 kanë qenë edhe drejtorë të drejtorive komunale, si drejtori i BPZHR-së z.Berat Duraku, drejtori i UPMM-së z.Rumir Zhuniqi, drejtori i Shërbimeve Publike z.Përparim Krasniqi, drejtoresha e Administratës znjsh.Saranda Sallteku, drejtori i DPI-së z.Besnik Hoti, drejtori i DKA-së, z.Avni Morina, drejtori i DGJKP-së z.Afrim Oruqi drejtori i DEZHT-së z.Artan Asllani, drejtoresha e DKRS-së, znjsh.Bjondina Kleqka, drejtori i DSHPS-së, z.Samir Mustafa dhe drejtori i DMSH-së z. Hasan Përboqi të cilët patën mundësi të dëgjojnë kërkesat dhe prioritetet e qytetarëve të Komunës së Rahovecit për vitin 2021, po ashtu në rast nevojë për sqarime shtesë në lidhur me ndonjë çështje që i preokupon qytetarët tanë shprehën gatishmërinë për dhënien e sqarimeve të kërkuara nga ana e tyre.

PROCESVERBALI I DËGJIMEVE PUBLIKE ME QYTETARËT E KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT PËR VITIN 2021

Në vazhdim në bazë të procesverbalit të mbajtur për të gjitha dëgjimet publike me qytetarët e Komunës së Rahovecit për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021 të evidentuara janë:

- *Data e mbajtjes së dëgjimit publik,*
- *Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale dhe anëtarët pjesëmarrës nga Komiteti për Politikë dhe Financa,*
- *Ora dhe vendi i mbajtjes së dëgjimit publik me qytetarët e Komunës së Rahovecit për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021,*
- *Kërkesat e evidentuara gjatë mbajtjes së dëgjimit publik me qytetarët e Komunës së Rahovecit për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021,*
- *Numrin e pjesëmarrësve në dëgjime publike me qytetarët e Komunës së Rahovecit për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021.*

PROCESVERBAL- RAPORT MBI DËGJIMET BUXHETORE

Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së Data e mbajtjes së dëgjimit publik	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Total	
6 korrik 2020 Pjesëmarrës: Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina, Drejtori i DPF-së z. Afrim Limani. Anëtarë të KPF-së: z. Rasim Fazliu, z. Fehmi Cena, znj. znjsh. Fjolla Duraku, z.Dervish Cadraku, znj. Florida Bajraktari dhe znj. Farije Lushii Drejtore të Drejtorive Procesmbajtëse: Nora Boshnjaku	"Qendra Rinore" Fshati –Krushë e Madhe. Dëgjim publik me qytetarët e fshatit Krushë e Madhe Ora : 19:00	12	1	13	Krushë e Madhe Selami Hoti, kryetar i këshillit të fshatit Krushë e Madhe tha se ne si kryesi e fshatit jemi takuar dhe kemi biseduar lidhur me kërkesat, por që të gjitha kërkesat e renditura sipas prioriteteve do t'ju dorëzojmë tek Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës, të nënshkruara dhe të protokoluara. Celinë Rregullimi i rrugëve me kubëza, riparimi i Shtëpisë së Kulturës, rregullimi i kanalizimeve në fshat, zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik, rregullimi i fushës sportive, rregullimi i rrugëve fushore, përkrahja e bujqve me mekanizëm bujqësor. Nagac Rregullimi i rrugës së Meleskës, rregullimi i fushës sportive, hapja e rrugës për kycje për në qytetin e Rahovecit dhe kubëzimi i rrugëve përbrenda fshatit.



KOMUNA RAHOVEC- KORRIK 2020

KRUSHË E MADHE



PROCESVERBAL- RAPORT MBI DËGJIMET BUXHETORE

Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Total	
Data e mbajtjes së dëgjimit publik 6 korrik 2020					
Pjesëmarrës: Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina, Drejtori i DPF-së z. Afrim Limani.	Shkolla fillore "Heronjtë e Kosovës" fshati Hoçë e Vogël- Brestoc	8	/	8	Hoçë e Vogël Rregullimi i prroskave, kubëzimi i rrugëve ndërtimi i trotuarëve, rregullimi i kanalizimit, rregullimi rrugëve fushore, pastrimi i mbeturinave të ngurta, rregullim i dy parqeve, rregullimi i sistemit të ujitjes, mirëmbajtja e fushës sportive dhe mbjellja e drunjve dekorativ.
Anëtarë të KPF-së: z. Rasim Fazliu, z. Fehmi Cena, znj. znjsh. Fjolla Duraku, z.Dervish Cadraku, znj. Florida Bajraktari dhe znj. Farije Lushii	Dëgjim publik me qytetarët e fshatrave: Hoçë e Vogël dhe Brestoc.				Brestoc Hapja e kanalizimit, rregullimi i rrugës "Dituria", kërkesat tjera do të sillen të protokoluara nga kryetari i fshatit Brestoc, z.Masar Elshani.
Drejtorë të Drejtorive.	Ora : 20:00				

HOÇË E VOGËL-

BRESTOC



PROCESVERBAL- RAPORT MBI DËGJIMET BUXHETORE

Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Total	
Data e mbajtjes së dëgjimit publik 7 korrik 2020					
Pjesëmarrës: Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina, Drejtori i DPF-së z. Afrim Limani. Anëtarë të KPF-së: z. Rasim Fazliu, z. Fehmi Cena, znj. znjsh. Fjolla Duraku, z.Dervish Cadraku, znj. Florida Bajraktari dhe znj. Farije Lushii Drejtore të Drejtorive	Shkolla fillore "Skënder Kastrati " fshati Malësi e Vogël Dëgjim publik me qytetarët e fshatrave Malësi e Vogël dhe Gexhë Ora : 19:00	12	/	12	Malësi e Vogël Kompletimi i trotuarëve në fshat, kubëzimi i dy rrugëve, rregullimi i kanalizimit më tre lagje, rregullimi i katër përroskave me gjatësi prej 2800 metra, rregullimi i dy parqeve, kubëzimi i parkingjeve tek ambulanta dhe hyrja e oborrit të shkollës, vazhdimi i rregullimit të përroit pas fshatit pjesa nga fshati Ratkoc, rregullimi i katër rrugëve fushore me gjatësi prej 2500 metra, rregullimi i oborrit të shtëpisë së fshatit dhe shpërndarja e mekanizmit bujqësorë për fermerët e fshatit. Gexhë Kryetari i këshillit të fshatit Gexhë, z.Leutrim Himaj, ka qenë i njoftuar me kohë lidhur me mbajtjen e dëgjimit public mirëpo për arsye të ndryshme nuk ka marrë pjesë asnjë qytetar nga fshati Gexhë e as nga kryesia e këshillit të fshatit, andaj kërkesat priten që t'i sjellë ditëve në vijim të protokoluara në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal- Rahovec.



**MALËSI
E VOGËL**



PROCESVERBAL- RAPORT MBI DËGJIMET BUXHETORE

Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së Data e mbajtjes së dëgjimit publik	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Total	
7 korrik 2020 Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina, Drejtori i DPF-së z. Afrim Limani. Anëtarë të KPF-së: z. Rasim Fazliu, z. Fehmi Cena, znj. znjsh. Fjolla Duraku, z.Dervish Cadraku, znj. Florida Bajraktari dhe znj. Farije Lushii Drejtore të Drejtorive	Shkolla fillore "Katër Dëshmorët " fshati Ratkoc Dëgjim publik me qytetarët e fshatrave Ratkoc, Dejnë, Vrajakë, Bratotin Ora : 20:00	18	1	19	Ratkoc Mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor, rregullimi i kanalizimit, kubëzimi i rrugëve të fshatit, vazhdimi i ndriçimit, rregullimi i rrugëve fushore, rregullimi i dy përroskave, zgjerimi i rrjetit të ujit të pijes dhe ujit të ujitjes, rregullimi i ndriçimit në oborrin e ambulancës, oborrit të shkollës së fillore dhe të mesme, rregullimi i shtratit të Drinit të Bardh, ndalimi i hedhjes së mbeturinave, rregullimi i shtegut të ecjes dhe mbjellja e drunjve dekorativ. Dejnë Rregullimi i kanalizimit, mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësorë, rregullimi i rrugëve fushore, rregullimi i kanalizimit të ujërave atmosferik, hapja e dy rrugëve fushore, rregullimi i trotuarit që lidh fshatrat Dejnë-Ratkoc, rregullimi i rrethojës së oborrit të shkollës dhe shenjëzimi i rrugëve. Vrajakë Rregullimi i kanalizimit në mes të fshatrave: Vrajakë-Ratkoc, rregullimi i trotuarit Vrajakë-Ratkoc, rregullimi i rrugëve fushore dhe kubëzimi i një rruge të fshatit. Bratotin Mekanizëm bujqësorë për fermerët e fshatit, rregullimi i rrugëve fushore, rregullimi i ndriçimit publik ndërtimi i një muri mbrojtës tek varrezat e fshatit, rregullimi i trotuarit Bratotin- Vrajakë-Ratkoc, kubëzimi i rrugëve, mbështetje për grante për bujqësi.

PROCESVERBAL- RAPORT MBI DËGJIMET BUXHETORE

RATKOC



Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Total	
Data e mbajtjes së dëgjimit publik 8 korrik 2020					
Kryesuesi i KK-Rahovec z.Afrim Dina, Drejtori i DPF-së z. Afrim Limani. Anëtarë të KPF-së: Rasim Fazliu, z. Fehmi Cena, znj. znjsh. Fjolla Duraku, z.Dervish Cadraku, znj. Florida Bajraktari dhe znj. Farije Lushi Drejtorë të Drejtorive	Shkolla fillore "Rilindja " fshati Çifllak Dëgjim publik me qytetarët e fshatrave Çifllak, Polluzhë, Dobidol Ora : 19:00	7	/	7	Çifllak Shpërndarja e mekanizmit bujqësorë dhe serrave për fermer, rregullimi i kanalizimit në dy lagje, kubëzimi i rrugëve të fshatit, rregullimi i ndriçimit publik, renovimi i objektit të shkollës dhe rregullimi i rrugëve fushore, rregullimi i urës. Polluzhë Kryetari i këshillit të fshatit Polluzhë, z.Jonuz Hoti, ka qenë i njoftuar me kohë lidhur me mbajtjen e dëgjimit publik mirëpo për arsye të ndryshme nuk ka marrë pjesë asnjë qytetar nga fshati Polluzhë e as nga kryesia e këshillit të fshatit, andaj kërkesat pritet që t'i sjellë ditëve në vijim të protokoluara në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal- Rahovec. Dobidol Hapja e kanaleve për ujërat atmosferik, riparimi i objektit të shkollës, rrethimi dhe rregullimi i oborrit të shkollës, rregullimi i rrugëve fushore, kubëzimi i rrugëve, rregullimi i trotuarit Dobidol-Dejnë, ndërtimi i një fushe sportive, shteg për ecje, rregullimi i ndriçimit publik, mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësorë, rregullimi i një shtegu për ecje, rregullimi i një ure Dobidol-Doblibare dhe menaxhimi i mbeturinave.



ÇIFLLAK



Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Total	
Data e mbajtjes së dëgjimit publik 8 korrik 2020 Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina, Drejtori i DPF-së z. Afrim Limani. Anëtarë të KPF-së: Rasim Fazliu, z. Fehmi Cena, znj. znjsh. Fjolla Duraku, z.Dervish Cadraku, znj. Florida Bajraktari dhe znj. Farije Lushi Drejtorë të Drejtorive	Shkolla fillore "Mustafë Ibishi " fshati Kramovik Dëgjim publik me qytetarët e fshatrave Kramovik, Guri i Kuq dhe Mrasor. Ora : 20:00	18	/	18	Kramovik Rregullimi i rrugëve fushore, ndriçimi publik në rrugën kryesore të fshatit, rregullimi i kanalizimit, kubëzimi i rrugëve, zgjerimi i sistemit të ujitjes dhe rregullimi i oborrit të shkollës. Guri i Kuq Kubëzimi i dy rrugëve, rregullimi i një trotuari me gjatësi prej 400 metrave dhe rregullimi i rrugëve fushore. Mrasor Rregullimi i sistemit të ujit të pijes, rregullimi i kanalizimit, rregullimi i rrugëve fushore, kubëzimi i rrugëve, rregullimi i sistemit të ujitjes dhe rregullimi i ndriçimit publik.



KRAMOVIK



Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Total	
Data e mbajtjes së dëgjimit publik 9 korrik 2020 Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina, Drejtori i DPF-së z. Afrim Limani. Anëtarë të KPF-së: Rasim Fazliu, z. Fehmi Cena, znj. znjsh. Fjolla Duraku, z.Dervish Cadraku, znj. Florida Bajraktari dhe znj. Farije Lushi Asamblist/e Masar Popaj Drejtorë të Drejtoreve	Shkolla fillore "Liria " Fshati Fortesë. Dëgjim publik me qytetarët e fshatrave Fortesë, Sopniq, Pataqan i Ulët dhe Pataqan i Epërm. Ora : 19:00	4	/	4	Fortesë Përfundimi i ndërtimit të objektit të shkollës fillore, rregullimi i ndriçimit publik, rregullimi i rrugëve fushore, kubëzimi i rrugëve, rregullimi i kanalizimeve, rregullimi i shtratit të lumit "Belleja" deri në dalje tek Drini i Bardhë, rregullimi i varrezave dhe rregullimi i terreneve sportive. Sopniq Rregullimi i kanalizimeve të ujerave të zeza, rregullimi i ndriçimit publik, kubëzimi i rrugëve, rregullimi i rrugëve fushore dhe hapja e një rruge që lidh fshatrat Sapniq-Fortesë. Pataqan i Ulët Rregullimi i përroshkave të fshatit, rregullimi i kanalizimeve, kubëzimi i rrugëve, rregullimi i ndriçimit publik, rregullimi i trotuarit përgjatë rrugës kryesore të fshatit dhe rregullimi i rrugëve fushore. Pataqan i Epërm Kryetari i këshillit të fshatit, Pataqan i Epërm, z.Selim Bellaqa ka qenë i njoftuar lidhur me mbajtjen e dëgjimit publik mirëpo për arsye të ndryshme nuk ka marrë pjesë asnjë qytetar nga ky fshat e as nga kryesia e këshillit të fshatit, andaj kërkesat pritet që t'i sjellë ditëve në vijim të protokoluara në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal- Rahovec.

PROCESVERBAL- RAPORT MBI DËGJIMET BUXHETORE



FORTESË



Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Total	
Data e mbajtjes së dëgjimit publik 10 korrik 2020 <i>Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina, Drejtori i DPF-së z. Afrim Limani.</i> <i>Anëtarë të KPF-së: Rasim Fazliu, z. Fehmi Cena, znj. znjsh. Fjolla Duraku, z.Dervish Cadraku, znj. Florida Bajraktari dhe znj. Farije Lushi</i> <i>Drejtorë të Drejtorive</i>	Shtëpia e Kulturës në fshatin Xërxe Dëgjim publik me qytetarët e fshatit Xërxe Ora : 20:00	5	/	5	Xërxe Kubëzimi i rrugëve brenda fshatit, rregullimi i ndriçimit publik, rregullimi i kanalizimit, ndërtimi i objekti të ri të shkollës, rregullimi i udhëkryqit afër shkollës, trajtimi i kanalit afër shkollës, rrethimi i varrezave të fshatit.



XËRXE



PROCESVERBAL- RAPORT MBI DËGJIMET BUXHETORE

Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Total	
Data e mbajtjes së dëgjimit publik 10 korrik 2020					
Kryesuesi i KK-Rahovec z.Afrim Dina, Drejtori i DPF-së z. Afrim Limani.	Shtëpia e Kulturës "Feim Gashi" fshati Drenoc.	12	/	12	Drenoc Ndërtimi i trotuarit, ndriçimi publik, kubëzimi i rrugëve, rregullimi i rrugëve, rregullimi i rrugëve fushore dhe ndërtimi i një fushe sportive.
Anëtarë të KPF-së: Rasim Fazliu, z. Fehmi Cena, znj. znjsh. Fjolla Duraku, z.Dervish Cadraku, znj. Florida Bajraktari dhe znj. Farije Lushi	Dëgjim publik me qytetarët e fshatrave Drenoc, Pastasellë, Senoc.				Pastasellë Rregullimi i kanalizimeve, kubëzimi i rrugëve, largimi i mbeturinave inerte, rregullimi i trotuarit përgjatë rrugës kryesore, ndërtimi i një parku dhe mbjellja e drunjve dekorativ.
Drejtorë të Drejtorive	Ora : 18:00				Senoc Kubëzimi i rrugëve, rregullimi i kanalizimit, rregullimi i ndriçimit publik përgjatë rrugës kryesore, rregullimi i parkut të fshatit dhe evitimi i problemeve me ujë të pijes.

DRENOC



PROCESVERBAL- RAPORT MBI DËGJIMET BUXHETORE

Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Total	
10 korrik 2020	Shtëpia e Kulturës "Feim Gashi" fshat Drenoc. Dëgjim publik me qytetarët e fshatrave Zatriq, Koznik dhe Nushpal Ora : 18:00		/		Zatriq Rregullimi i ujit të pijes, kubëzimi i rrugëve, rregullimi i terreneve sportive, ndërtimi i kanalizimit, rregullimi i ndriçimit publik, rregullimi i rrugëve fushore dhe rregullimi i shtratit të përroskës së fshatit. Koznik- Potok Kryetari i këshillit të fshatit, Koznik-Potok, z.Kamer Isakaj ka qenë i njoftuar lidhur me mbajtjen e dëgjimit publik mirëpo për arsye të ndryshme nuk ka marrë pjesë asnjë qytetar nga ky fshat e as nga kryesia e këshillit të fshatit, andaj kërkesat pritet që t'i sjellë ditëve në vijim të protokoluara në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal- Rahovec Nushpal Kryetari i këshillit të fshatit, Nushpal, z.Fatmir Morina ka qenë i njoftuar lidhur me mbajtjen e dëgjimit publik mirëpo për arsye të ndryshme nuk ka marrë pjesë asnjë qytetar nga ky fshat e as nga kryesia e këshillit të fshatit, andaj kërkesat pritet që t'i sjellë ditëve në vijim të protokoluara në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal- Rahovec.



KOMUNA RAHOVEC- KORRIK 2020

PROCESVERBAL- RAPORT MBI DËGJIMET BUXHETORE

Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Tota	
Data e mbajtjes së dëgjimit publik					
13 korrik 2020 <i>Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina, Drejtori i DPF-së z. Afrim Limani.</i>	Shkolla fillore "Lidhja e Prizrenit" fshati Opterushë Dëgjim publik me qytetarët e fshatrave Opterushë, Zoqisht, Retijë e Poshtme dhe Retijë. Ora : 19:00	19	/	19	Opterushë Hapja e rrugëve fushore dhe mirëmbajtja, rregullimi i rrethojave të shkollës, kubëzimi i rrugëve, zgjerimi i kanalizimit, mirëmbajtja e lumit të fshatit deri në fshatin Retijë, rregullimi i kompleksit memorial të dëshmorëve dhe martirëve, rregullimi i një parku, caktimi i një lokacioni të ri për varreza, kyçja në sistemin e ujit në KRU "Gjakova", shtrirja e tensionit të lartë të rrymës, mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor dhe subvencionimi i bizneseve. Zoqisht Kubëzimi i rrugëve të fshatit, vazhdimi i rregullimit të shtratit të lumit, rregullimi i rrugëve fushore, rregullimi i terreneve sportive dhe rregullimi i kanalizimeve. Retijë e Poshtme Rregullimi i rrugëve fushore, ndërtimi i një fushe sportive, rregullimi i një parku në hyrje të fshatit, renovimi i objektit të shkollës brenda dhe jashtë, aktivizimi i klasës parashkollor, sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve të fshatit, mërimi i rrugëve , zgjerimi i ndriçimit publik, pastrimi i gropës septike, kubëzimi i rrugëve dhe mbjellja e drunjve dekorativ. Retijë Kryetari i këshillit të fshatit, Retijë, z.Safet Thaci ka qenë i njoftuar lidhur me mbajtjen e dëgjimit publik mirëpo për arsye të ndryshme nuk ka marrë pjesë asnjë qytetar nga ky fshat e as nga kryesia e këshillit të fshatit, andaj kërkesat pritet që t'i sjellë ditëve në vijim të protokoluara në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal- Rahovec
<i>Anëtarë të KPF-së: Rasim Fazliu, z. Fehmi Cena, znj. znjsh. Fjolla Duraku, z.Dervish Cadraku, znj. Florida Bajraktari dhe znj. Farije Lushi</i>					
<i>Drejtorë të Drejtorive</i>					
<i>Asamblit/e – Besmire Bytyçi</i>					

OPTERUSHË



Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Total	
Data e mbajtjes së dëgjimit publik 14 korrik 2020 Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina, Drejtori i DPF-së z. Afrim Limani. Anëtarë të KPF-së: Rasim Fazliu, z. Fehmi Cena, znj. znjsh. Fjolla Duraku, z.Dervish Cadraku, znj. Florida Bajraktari dhe znj. Farije Lushi Drejtorë të Drejtorive	Salla e Kuvendit Komunal- Rahovec Dëgjim publik me biznese të komunës së Rahovecit. Ora : 16:00 Dëgjim publik me grupin e Grave- Buxhetimi gjinor dhe të gjitha OJQ-të. Ora : 15:00	1	10	11	Takimi me biznese të komunës së Rahovecit Takimi me biznese të komunës së Rahovecit nuk është mbajtur për shkak të mos pjesëmarrjes së bizneseve të komunës së Rahovecit. Takimi me OJQ-të në Komunën e Rahovecit Përkrahja e personave me nevoja të veçanta, përkrahja e shoqatës për vizita nëpër shtëpia të personave me nevoja të veçanta. Kategorizimi i ndarjes së subvencioneve si në kulturë, rini dhe sport. Takim me grupin e Grave- Buxhetimi gjinor Lirimi i trotuareve, rregullimi i hapësirave rekreative, lehtësira në punësim, trajtimi dhe largimi i qenve endacakë, shërbimi mjekësor-mamografia, strisha dhe mësimi joformal.



Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Total	
Data e mbajtjes së dëgjimit publik 15 korrik 2020 Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina, Drejtari DPF-së z. Afrim Limani. Anëtarë të KPF-së: Rasim Fazliu, z. Fehmi Cena, znj. znjsh. Fjolla Duraku, z.Dervish Cadraku, znj. Florida Bajraktari dhe znj. Farije Lushi Drejtorë të Drejtore	Shtëpia e Kulturës – fshati Hoçë e Madhe Ora : 15:00 Qendra Rinore” SHL Kosova”, Rahovec. Dëgjim publik me të rinjtë e Komunës së Rahovecit Ora : 17:30	8	/	8	Hoçë e Madhe Rregullimi i ujit të pijes, rregullimi i ndriçimit publik, kubëzimi i rrugëve, rregullimi i shtratit të lumit të fshatit, zëvendësimi i shtyllave të rrymës, pastrimi i shtratit të lumit dhe rregullimi i rrugës së Manastirit të fshatit. Takimi me të rinjtë e Komunës së Rahovecit Mbështetja e aktiviteteve kulturore si në lexim dhe teatër, sigurimi i transportit për vullnetarët e “SHL-Kosova” të cilët janë të interesuar që të marrin pjesë nëpër aktivitetet që i organizon qendra rinore “SHL-Kosova”, aktivitete ka shumë por që të rinjtë nuk kanë mundësi që të paguajnë transportin, formimi i klubit të leximit dhe furnizimi me libra, organizimi i kampanjave të ndryshme vetëdijesuese në veçanti kampanja që kanë të bëjnë me barazi gjinore.

PROCESVERBAL- RAPORT MBI DËGJIMET BUXHETORE



Pjesëmarrësit e Qeverisë Komunale- KPF-së Data e mbajtjes së dëgjimit publik	Lokaliteti/ Vendbanimi/ Ora	Numri i pjesëmarrësve			Përfundimet- Kërkesat
		M	F	Total	
16 korrik 2020 Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina, Drejtori i DPF-së z. Afrim Limani. Anëtarë të KPF-së: Rasim Fazliu, z. Fehmi Cena, znj. znjsh. Fjolla Duraku, z.Dervish Cadraku, znj. Florida Bajraktari dhe znj. Farije Lushi Drejtorë të Drejtorive	Dëgjim publik me qytetarë të Rahovecit, Lagjja I, II, III, IV, V – Shkolla e mesme "Xhelal Hajda" Ora : 19:00	21	1	22	Rahovec, Lagjja I Riparimi i parkut në qendër, mirëmbajtja e hapësirave publike, zgjidhja e problemit e rrethrotullimit në qendër, zgjidhja e kontestit të dyqanit- ish " BULOVA", pajisja me ulëse për qëndrim të qytetarëve, krijimi i hapësirave sportive për të rinjtë, rregullimi i infrastrukturës rrugore dhe kanalizimit në rrugën Halil Hamza, hapja e rrugës tek ish fabrika "18 Nëntori", ndërtimi i një AMF-je tek ish Gjimnazi i vjetër, vendqëndrim për pensionistët, vendosja e rrethojës tek gropa, në rrugën " Shejh Mehidini". Rahovec, Lagjja II Rregullimi i rrugëve me kubëza, rregullimi i varrezave të martirëve, rregullimi i trotuareve dhe shenjëzimi i rrugëve, rregullimi i rrugës dytësore në rr. "Mexhit Mustafa", kërkesë për vendosjen e pengesave në rrugë tek shkolla "Bekim Sylka" Rahovec, Lagjja III Furnizimi me ujë të pijshëm gjatë sezonës verore, ndriçim publik në disa pjesë të lagjes, kubëzimi rrugicave, shenjëzimi i rrugëve, vendosja e kanalizimit në disa pjesë të lagjes, vendosja e rrethojave në transit.

PROCESVERBAL- RAPORT MBI DËGJIMET BUXHETORE

				Rahovec, Lagja IV Ndriçim publik në rrugën "Muharrem Dina" tek parku i qytetit, kërkesat tjera do të sillen nga kryetari i lagjes IV, z.Luan Kleqka të protokolluara në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal- Rahovec, z.Afrim Dina. Rahovec, Lagja V Vazhdimi i rregullimit të trotuarit në rr. "Gëzim Hamza- Piktori", rregullimi i infrastrukturës rrugore tek shkolla "Sadedin Hajda", dhe rruga "Bedredin Shehu", rregullimi i rrugëve fushore dhe kanalit kullues.
--	--	--	--	--



Kalendari i dëgjimeve publike me qytetarët e Komunës së Rahovecit për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021.

[illegible]

PËRFUNDIM

Përmes mbajtjes së dëgjimeve buxhetore bëhen përpjekje për krijimin e një kornize të qartë përmes së cilës qytetarët, dhe shoqëria civile në përgjithësi, përfshihen në monitorimin e shfrytëzimit të parasë publike dhe vlerësimin e udhëheqjes së politikës fiskale.

Duke u nisur nga fakti se qytetarët janë aksionar të qeverisë që përzgjedhin, atëherë mbajtja e dëgjimeve buxhetore u mundëson qytetarëve të mbikëqyrin menaxhimin e taksave të tyre.

Në këtë aspekt, mbajtja e dëgjimeve buxhetore kontribuon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së këtij procesi duke analizuar politikat buxhetore të qeverisë lokale, shfaq të metat e procesit buxhetor dhe jep rekomandime për praktika të mira përgjatë procesit përgaditor të buxhetit.

Ky raport- procesverbal i'u dërgohet:

- Kryesuesit të Kuvendit Komunal Rahovec
- Drejtorit të drejtorisë për buxhet dhe financa
- Anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa
- Drejtorëve të drejtorive komunale
- Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Afrim Dila

Kryesues i KK - Rahovec



Afrim Limani

Drejtor i DBF-së

Rahovec

17 korrik 2020

Nora Boshnjaku

Procesmbajtëse